



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 32 të Ligjit Nr. 08/L-153 mbi edukimin në fëmijërinë e hershme , Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.17 e datës 3 gusht 2023 , Udhëzimit Administrativ nr. 41/2007 - Zbritja e tarifave që duhet të paguhet nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____ 2023, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

**MBI CAKTIMIN E TARIFAVE PËR QËNDRIMIN DITOR TË FËMIJËVE NË
INSTITUCIONET PARASHKOLLORE NË FSHATRA TË KOMUNËS SË LIPJANIT**

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Vendim përcaktohen obligimet e prindërve për pagesën e tarifave, procedura për lirim nga pagesa e këtyre tarifave , zvogëlimet e tarifave dhe aplikimi i tarifave për qëndrim ditor të fëmijëve në Institucionet parashkollore në fshatrat e Komunës së Lipjanit.

Neni 2
Kompenzimi për qëndrim ditor

Prindërit, përkatësisht kujdestarët, për vendosjen e fëmijëve për qëndrim ditor në Institucionet parashkollore funksionale në fshatrat e Komunës së Lipjanit , në emër të participimit për një fëmijë, për çdo muaj duhet të paguajnë shumën prej 30.00 €.

Neni 3
Lirimi nga pagesa e tarifave

Lirimi nga pagesat e përcaktuara në nenin 1 të këtij Vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat ligjore .

Neni 4
Zvogëlimi i tarifave

Prindërit përkatësisht kujdestarët e fëmijëve do të paguajnë tarifën e zvogëluar për qëndrimin ditor për më shumë se një fëmijë, s'i vijon:

Për fëmijën e dytë shumën prej 21.00 €.

Për fëmijën e tretë shumën prej 15.00 €.

Neni 5
Aplikimi i Tarifave

Aplikimi i tarifave të cekura në nenin 2 dhe 4 të këtij Vendimi do të fillojë menjëherë, pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr.15-610/07-52751 i datës 28.09.2022 mbi caktimin e tarifave për qëndrimin ditor të fëmijëve në dy institucionet parashkollore në fshatrat Gadime dhe Sllovi.

A r s y e t i m i

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim -vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, , nenit 32 të Ligjit Nr. 08/L-153 mbi edukimin në

fëmijërinë e hershme, Udhëzimit Administrativ nr. 41/2007 - Zbritja e tarifave që duhet të paguhen nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Me dispozitat e nenit 32 të Ligjit mbi edukimin në fëmijërinë e hershme, parashihet: "Tarifën për pagesën e vijueshmërisë së fëmijës në institucion publik të Edukimit në fëmijërinë e hershme e përcakton komuna përkatëse, në bazë të standardit komunal të jetesës dhe në mënyrë të përshtatshme"

Propozimi i tarifave me shumat e propozuara më lartë bëhet kryesisht me qëllim të përkrahjes dhe nxitjes së punësimit të nënave në fshatrat e Komunës së Lipjanit e posaqërisht në viset rurale, pasi supozohet se mund të ndikojë edhe në ndalimin e shpërnguljes së banorëve nga fshatrat në qytet.

Duke u bazuar në dispozitën e sipër cituar propozojmë miratimin e këtij Vendimi.

1Nr. 400/01-55419
Lipjan, më 27-09 2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

